



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 13, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, nr. 06/L-092, nenit 6 paragrafi 1, i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nr. 09/2020, nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM NË VITIN 2022

- I. **MIRATOHET** lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2022.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, lista për secilën pronë të paluajtshme, e cila planifikohet të jepet në shfrytëzim deri më 31.12.2022, përmban: nr. e parcelës, sipërfaqen m², zonën kadastrale dhe destinimin e dhënies në shfrytëzim.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e veçantë e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022, përfshirë certifikatën e pronësisë, kopjen e planit, si dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për secilën pronë.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë e tjera relevante.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-62843/22, më 21.03.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

